



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar

Numër 1

S h k u r t 2 0 2 0

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve për Inflacionin

Numër 1

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: ++383 38 222 055

Fax: ++383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Përmbajtja

Anketa e Kreditimit Bankar	6
Kutia 1. Metodologjia	9
Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe kërkesën për kredi.....	10
Kreditë ndaj ndërmarrjeve	10
Standardet kreditore	10
Kushtet dhe rregullat.....	11
Kërkesa për kredi.....	12
Kreditë ndaj ekonomive familjare	12
Standardet kreditore	12
Kushtet dhe rregullat.....	13
Kërkesa për kredi.....	14
Financimi	15
Pritjet për Inflacionin	16
Hyrje	16
Metodologjia	16
Përmbledhja e rezultateve	17
Shtojcat	Error! Bookmark not defined.

Anketa e Kreditimit Bankar

Hyrje

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë të re me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi do të publikohet në frekuencë tremujore në web faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim si pasojë. Analizimi më i hollësishëm i ofertës kreditore të bankave komerciale, shprehur përmes ndryshimeve në standardet kreditore dhe rregullave dhe kushteve kreditore, si dhe i kërkesës për kredi, do të mundësoj të kuptuarit e faktorëve që ndikojnë drejtpërdrejtë në gatishmërinë e bankave për të rritur ndërmjetësimin financiar në vend dhe do të ndihmojë akterët në treg për të parashikuar vëllimet kreditore dhe përkthimin e tyre në rritjen e PBB-së. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2019, dhe pritjet e bankave për dinamikat në kreditim për tremujorin e katërt të vitit 2019,

Duke marrë parasysh mungesën e tregut të kapitalit, akterët në treg si ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare në Kosovë kryesisht mbështeten në kreditim bankar për të plotësuar nevojat e tyre për financim. Rrjedhimisht, ndikimi i sektorit bankar në aktivitetin ekonomik rezulton të jetë shumë më i drejtpërdrejtë dhe i lartë krahasuar me vendet e zhvilluara. Për pasojë, analizimi i sjelljes kreditore në Kosovë ka rëndësi shumë të madhe si për identifikimin e faktorëve specifik me ndikim në dinamikat e kreditimit (ofertë dhe kërkesë), ashtu edhe për parashikimin më të mirë të cikleve të ekonomike dhe financiare në vend.

Të dhënat e përfituara nga kjo anketë do të mund të shërbejnë si informacione plotësuese për statistikat rreth aktivitetit të sistemit bankar, duke mundësuar kështu një analizë më të plotë të zhvillimeve në këtë sektor. Për më tepër, perspektiva që ofron anketa mbi dinamikat në kërkesën e klientëve për kredi, dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimin e kërkesës, plotëson dhe ndihmon analizat për performancën e sektorit privat, sektor që vazhdon të ketë hendek në të dhëna (si performanca financiare e ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve).

Me fillim në vitin 2012, BQK ka implementuar Anketën e Kreditimit Bankar duke u mbështetur në metodologjinë e zhvilluar nga Banka Qendrore Evropiane për të vlerësuar sjelljen e bankave që operojnë në eurozonë për sa i përket aktivitetit kredidhënës. Kjo anketë është zhvilluar në baza tremujore deri në vitin 2015, kur është zëvendësuar me anketën e realizuar në bashkëpunim me Bankën Investive Evropiane (BIE) në baza gjashtëmujore. Duke filluar nga Qershori 2019, Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit, e mbështetur në metodologjitë tashmë të standardizuara për anketim me institucionet financiare, është përshtatur për qëllimet dhe nevojat analitike të BQK-së Rrjedhimisht, duke marr parasysh që anketat e realizuara deri tash kanë thyrje sepse janë mbështetur në metodologji relativisht të ndryshme dhe në frekuencë tjetër, seria kohore është e kufizuar dhe nuk mundëson analizë krahasuese në dinamikat e kreditimit.

Përmbledhja e rezultateve

Dinamika e aktivitetit kreditues për ndërmarrjet gjatë tremujorit të tretë 2019, sipas anketës së kreditimit bankar, rezulton të jetë ndikuar negativisht si nga ana e ofertës kreditore ashtu edhe nga ana e kërkesës për kredi. Në linjë me këtë zhvillim stoku i kredive për korporatat jo financiare (KJP) u shtua për 72.5 milionë euro gjatë TM2 2019, përderisa kishte 6.0 milionë më pak gjatë TM3 2019.

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kanë shtrënguar deri në një masë standardet e aplikuara gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi, për dallim nga pritjet e deklaruara në anketën e kaluar. Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, standardet kreditore për ndërmarrjet e mëdha u shtrënguan në nivel më të lartë, përderisa për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), standardet kreditore mbetën pothuajse të pandryshuara. Për tremujorin e katërt të vitit 2019, bankat presin lehtësim të standardeve kreditore për të dy kategoritë, veçanërisht për NVM-të.

Faktorët kryesor që ndikuan në shtrëngimin e standardeve kreditore, sipas deklarimit të bankave, ishin toleranca e ulët ndaj rrezikut dhe faktorët ndërkombëtar - më saktësisht perspektiva jo e kënaqshme e bankave amë dhe cilësia jo e favorshme e portfolios kreditore në nivel ndërkombëtar. Në të njëjtën periudhë, ndikim pozitiv në lehtësim të standardeve kreditore për ndërmarrjet përmes kushteve më të favorshme të kreditimit kishte Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK).

Kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet u lehtësuan, megjithëse në një masë shumë më të ulët në krahasim me tremujorin paraparak. Mbështetja nga FKGK si dhe presioni i konkurrencës nga bankat tjera ndikuan në zbutjen e kushteve të kreditimit deri në një masë. Bankat presin që gjatë tremujorit të ardhshëm të lehtësojnë në masë më të madhe kushtet dhe rregullat për kreditë e reja, kryesisht për mes normave të interesit dhe ngarkesave tjera përveç interesit.

Gjatë tremujorit të tretë, kërkesa e ndërmarrjeve për kredi bankare rezultoi të ketë shënuar rënie, megjithëse në anketën e kaluar, bankat kishin raportuar pritjet për rritje të kërkesës nga segmenti i ndërmarrjeve. Indeksi negativ që rezultoi pas indeksimit të përgjigjeve të bankave lidhur me kërkesën për kredi i atribuohet kryesisht NVM-ve, përderisa kërkesa për kredi nga ndërmarrjet e mëdha mbeti kryesisht e pandryshuar. Në kuadër të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, e veçanërisht NVM-të, bankat deklaruan se kërkesë më të ulët kishin si për financimin të inventarëve dhe kapitalit punues, ashtu edhe të investimeve fikse. Gjithashtu, bankat deklaruan rritje të kërkesës për refinancim të borxhit, edhe pse rritje marginale, gjë që mund të jetë indikacion i vështirësive në performancën financiare që kanë hasur ndërmarrjet në këtë periudhë. Në TM4 2019, kërkesa për kredi pritjet të rritet dukshëm për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, me theks të veçantë për NVM-të.

Dinamikat e aktivitetit kreditues për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese, sipas anketës, u ndikuan pozitivisht si nga oferta kreditore ashtu edhe nga kërkesa e këtij segmenti. Standardet kreditore të aplikuara gjatë shqyrtimit të aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare u lehtësuan, në veçanti për kreditë konsumuese me afat të shkurtër maturimi. Pritjet e bankave për TM4 2019 japin indikacione për lehtësim më të lartë të standardeve kreditore për kreditë për blerjen e shtëpive, përderisa për segmentin e kredive konsumuese nuk presin ndryshime të dukshme.

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare u lehtësuan për të dy kategoritë e kreditimit, kryesisht përmes normave më të favorshme të interesit dhe rritjes së shumës së kredisë së aprovuar. Rritja e presioneve të konkurrencës nga sektori bankar, dhe në një masë më të ulët edhe sektori jo-bankar, rezultojnë të kenë qenë faktor kyç në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të kreditimit për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të tretë 2019. Përderisa, në tremujorin e ardhshëm pritjet lehtësimi i mëtutjeshëm i kushteve dhe rregullave, të ndikuar pozitivisht nga rreziku më i ulët i perceptuar nga ana e bankave, përmirësimi i cilësisë së portfolios kreditore dhe rritja e konkurrencës në mes të bankave në vend.

Bankat raportuan rritje të kërkesës për kredi të ekonomive familjare, nga të dy kategoritë përbërëse. Ngjashëm me tremujorin paraparak, mirëpo në kontrast me pritjet e bankave të deklaruara në anketën e kaluar, kërkesa për kredi konsumuese ishte më e lartë se sa kërkesa për kreditë për blerjen e shtëpive. Sipas anketës, rritja e kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare i atribuohet deri në një masë rritjes së nevojës për financimin e konsumit, si dhe zhvillimeve pozitive në tregun e pasurive të paluajtshme. Në tremujorin e katërt të vitit 2019, bankat presin rritje të dukshme të kërkesës për

kredi, e veçanërisht për kreditë afatgjata për blerjen e shtëpive, duke u mbështetur kryesisht në zhvillimeve e favorshme në tregun e pasurive të paluajtshme dhe në rritjen e besueshmërisë së konsumatorëve sa i përket aftësisë për ripagim të kredisë.

Bankat deklaruan për rritje të kënaqshme të gjithësej financimit në periudhën raportuese, konkretisht rritje të qëndrueshme të depozitave të ekonomive familjare dhe të ndërmarrjeve. Ndërsa, sa i përket afatit të maturimit, financimi afatshkurtër dominoi gjatë këtij tremujori. Ngjashëm, bankat presin rritje të qasjes në financim duke u mbështetur në depozitat e ekonomive familjare, mirëpo për dallim nga tremujori i kaluar, pritet që financimi afatgjatë të dominoj strukturën e fondeve. Gjithashtu, krahas TM3 2019, financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare pritet të rrisë mbështetjen në financimin e aktiviteteve të sektorit bankar.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar

Pyetësi i AKB është i bazuar në format e standardizuara të pyetësorëve të dizajnuar nga Bankat Qendrore në eurozonë dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKB është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKB përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën kreditore, ndryshimet në kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjes në financim të sektorit bankar. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe ndryshimeve të pritura gjatë tre muajve të ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKB mund të përmbajë edhe pyetje ‘ad hoc’ mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet ‘ad hoc’ mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohe më të gjatë. Në anketim marrin pjesë nëntë nga dhjetë bankat që operojnë në Kosovë. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithësej sektorit bankar dhe 99.8 përqind të gjithësej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimit apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit.

Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim / rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithsej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë.

Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.

Pyetësi, si dhe seria kohore e rezultateve të AKB, janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegzën e Anketës së Kreditimit Bankar.


Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe kërkesën për kredi

Kreditë ndaj ndërmarrjeve

Standardet kreditore

Standardet kreditore (udhëzimet e brendshme të bankave apo kriteret për aprovimin e kredive) të aplikuar për ndërmarrjet u shtrënguan lehtësisht gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019, të përkthyer në indeks negativ, edhe pse të ulët, prej 0.15. Në anketën e kaluar (TM2 2019), bankat kishin deklaruar pritjet e tyre që konsistonin në standarde të pandryshuara (figura 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuar për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuon



Burimi: BQK.

Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, standardet kreditore për ndërmarrjet e mëdha u shtrënguan në masë më të madhe (indeks negativ prej 0.15), përderisa për NVM-të, standardet kreditore mbetën pothuajse të pandryshuara. Vetëm një bankë, që njëkohësisht ka edhe peshë relativisht të lartë në gjithsej kreditë e lëshuara në nivel të sektorit, deklaroi shtrëngim deri në një masë për NVM-të që rezultoi në indeks negativ prej 0.09.

Sipas bankave, shtrëngimi i standardeve kreditore për ndërmarrjet kryesisht i'u atribuua tolerancës më të ulët ndaj rrezikut dhe faktorëve ndërkombëtar, më saktësisht perspektives jo të kënaqshme të bankave amë dhe cilësisë jo të favorshme të portfolios kreditore në nivel ndërkombëtar. Me përjashtim të rrezikut të perceptuar, faktorët e sipërpërmendur janë deklaruar nga vetëm një bankë, por si pasojë e peshës së lartë që ka kjo bankë në gjithsej tregun kreditor, u reflektua në indeksin e përgjithshëm. Në këtë periudhë, bankat deklaruan rrezik më të lartë të perceptuar në tregun e brendshëm, më konkretisht raportuan perceptimin për perspektivë jo të kënaqshme të tregut të brendshëm. Rol pozitiv dhe lehtësues në standardet e aplikuara nga bankat gjatë kësaj përudhe, rezultoi të ketë luajtur FKGK-ja, përderisa pothuajse të gjitha bankat raportuan ndikimin pozitiv të fondit në politikat e tyre kreditore. Ngjashëm me zhvillimet në standardet kreditore, edhe norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet e mëdha shënoi rënie gjatë këtij tremujori, përderisa për NVM-të norma e aprovimit të kredive mbeti pothuajse e pandryshuar.


Për tremujorin e fundit të vitit 2019, bankat presin lehtësim deri në një masë të standardeve kreditore për ndërmarrjet, me prioritet për NVM-të.

Kushtet dhe rregullat

Në tremujorin e tretë të vitit 2019, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet (kushtet dhe rregullat përkatëse të një kontrate të caktuar për kredi) u lehtësuan, mirëpo në një masë shumë më të ulët në krahasim me tremujorin paraprak (figura 2). Konkretisht, për dallim nga tremujori paraprak, normat e interesit mbetën të pandryshuara në këtë tremujor, përderisa madhësia e kredive të aprovuara u rrit kundrejt zvogëlimit të evidentuar në tremujorin paraprak.

Për shkak që kushtet dhe rregullat për ndërmarrjet e mëdha rezultojnë kryesisht të pandryshuara, të gjitha ecuritë e lartshënuara i atribuohen lëvizjeve në kushtet dhe rregullat e aplikuara për NVM-të.

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet



Burimi: BQK.


Faktorët që ndikuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave ishin kryesisht mbështetja nga FKGK me një indeks më të lartë (0.21) dhe presioni i konkurrencës nga bankat tjera në vend, edhe pse ky faktor kishte një indeks dukshëm më të ulët (0.08). Bankat po ashtu deklaruan që cilësia e portfolios kreditore në përgjithësi në nivel ndërkombëtar ka kontribuar në shtrëngim të kushteve dhe rregullave të aplikuara nga bankat në vend (indeks negativ prej -0.11).

Për tremujorin e katërt të vitit 2019, bankat pritet të kenë ofertë kreditore më të favorshme për ndërmarrjet duke u bazuar në kushtet dhe rregullat e ofruara. Në këtë kontekst, bankat deklaruan që do të ofrojnë norma më të ulëta të interesit dhe lehtësime në ngarkesat tjera përveç interesit, që nënkupton kampanjat e ndryshme që bankat aplikojnë në tremujorin e fundit. Nivel i përafërt i lehtësimeve pritet gjatë tremujorit të ardhshëm si për ndërmarrjet e mëdha ashtu edhe për NVM-të.

Kërkesa për kredi

Gjatë tremujorit të tretë, në përgjithësi, kërkesa për kredi nga ana e ndërmarrjeve shënoi rënie (indeks negativ prej 0.27) edhe pse në anketën e kaluar bankat kishin parashikuar rritje të kërkesës deri në një masë (indeks pozitiv prej 0.14) (figura 3). Rënia e kërkesës për ndërmarrjet në përgjithësi u ndikua nga rënia e kërkesës për kredi nga ana e NVM-ve, përderisa kërkesa për kredi nga ndërmarrjet e mëdha mbeti e pandryshuar.

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Sipas anketës, ndërmarrjet gjatë tremujorit të tretë nuk kanë financuar përmes kredive kapitalin fikse dhe as inventarët e kapitalin punues, rrjedhimisht të dy faktorët kishin indeks negativ. Ristrukturimi i borxhit u karakterizua me një indeks të ulët pozitiv, duke paraqitur situatën në një bankë të vetme. Sipas bankave, kjo ecuri mund t'i atribuohet sezonalitetit që e karakterizon këtë tremujor sa i përket aktivitetit të ndërmarrjeve. Po ashtu, ato theksuan se deri në një masë rënia e kërkesës u ndikua edhe nga gjendja politike në vend, ku si pasojë ndërmarrjet mund të kenë pezulluar planet investive të tyre deri në formimin e institucioneve shtetërore.

Përmirësim në cilësinë e aplikacioneve të pranuar kishte marginalisht në ato të ndërmarrjeve të mëdha, përderisa cilësia e aplikacioneve për kredi nga NVM-të mbeti po thuajse e pandryshuar.

Në tremujorin vijues, bankat presin aktivitet të hovshëm të ndërmarrjeve, duke e pasqyruar këtë në parashikimet e tyre për ndryshimet në kërkesën për kredi gjatë TM4 2019. Kërkesë dukshëm e rritur pritet nga NVM-të, ndërsa në një masë më të ulët nga ndërmarrjet e mëdha. Kërkesa e rritur për kredi pritet të ndikohet nga nevoja e ndërmarrjeve për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues.


Kreditë ndaj ekonomive familjare

Standardet kreditore

Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019 u lehtësuan në nivel më të lartë krahas tremujorit paraprak. Përderisa në anketën e kaluar bankat kishin deklaruar të presin lehtësim në masë më të vogël për këtë tremujor, rezultatet e TM3 2019 japin indikacion për lehtësim më të lartë. Ofertë më të volitshme kishte për kreditë konsumuese me

afat maturimi më të shkurtër krahas kredive për blerjen e shtëpive, me një indeks pozitiv prej 0.33, respektivisht 0.15 (figura 4). Në linjë me standardet kreditore, bankat po ashtu deklaruan të kenë rritur normën e aprovimit të kredive për ekonomitë familjare në përgjithësi, e në veçanti për kreditë konsumuese.

Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Burimi: BQK.

Në kuadër të segmentit të ekonomive familjare, faktor me ndikimin më të lartë në lehtësimin e standardeve kreditore ishte presioni nga konkurrenca, veçanërisht konkurrenca nga bankat tjera. Gjithashtu, në këtë tremujor, bankat deklaruan që rol lehtësues kishte edhe konkurrenca nga institucionet jo-bankare, veçanërisht tek kreditë konsumuese. Disa nga bankat e anketuara theksuan se lëshimi i kredive të shpejta, në shumica më të vogla dhe me kushte më të lehta nga ana e institucioneve jo-bankare ka rezultuar në pozicion disfavorizues të tyre në treg. Përderisa, lehtësimi i standardeve për kreditë për blerjen e shtëpive u realizua kryesisht përmes marrëveshjeve me kompani të ndërtimit, për sigurimin e kolateralit të nevojshëm dhe kushteve tjera lehtësuese. Faktor me kontribut pozitiv ishte edhe rritja e besueshmërisë mbi aftësitë paguese të huamarrësve, si dhe përmirësimi i cilësisë së portfolios kreditore në sektorin bankar në vend.


Në tremujorin e katërt 2019, bankat presin standarde kreditore të lehtësuara, mirëpo në nivel më të ulët krahas tremujorit të tretë. Standardet kreditore pritjet të lehtësohen kryesisht për kreditë për blerjen e shtëpive. Këto lehtësime pritjet të kenë si shtytës presionet nga konkurrenca, si nga sektori bankar ashtu edhe nga ai jo-bankar, si dhe perceptimin në ulje të rrezikut shprehur përmes rritjes së besueshmërisë mbi aftësinë paguese të huamarrësve.

Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja ndaj ekonomive familjare në përgjithësi u lehtësuan në tremujorin e tretë të vitit 2019. Lehtësim në një masë më të madhe kishin kreditë e reja për blerjen e shtëpive. Kryesisht, kushtet dhe rregullat për kreditë për blerjen e shtëpive u lehtësuan përmes rënies së normave të interesit (indeks pozitiv prej 0.27), rritjes së shumës së aprovuar dhe uljes së kërkesave për kolateral (indeks pozitiv prej 0.22). Përderisa, kushtet dhe rregullat për kreditë konsumuese u mbështetën përmes ofrimit të normave më të favorshme të interesit (indeks pozitiv prej 0.26) dhe rritjes së shumës së kredive të aprovuara (indeks pozitiv prej 0.15).

Faktorët që kontribuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të aplikuara janë kryesisht rritja e presioneve të konkurrencës nga sektori bankar, dhe në një masë më të ulët nga sektori jo-bankar.

Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Për tremujorin e fundit të vitit 2019, bankat presin lehtësim të mëtutjeshëm të kushteve dhe rregullave për kredi. Ngjashëm, bankat presin oferta më të volitshme për kreditë për blerjen e shtëpive kundrejt atyre konsumuese. Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja ndaj ekonomive familjare pritet të ndikohen pozitivisht nga rreziku më i ulët i perceptuar nga ana e bankave, siç janë perspektiva e kënaqshme për sektorin bankar në vend dhe tregun në përgjithësi, rrezik në rënie në kolateralin e kërkuar dhe rritjen e besueshmërisë mbi aftësitë paguese të huamarrësve. Po ashtu, ndikim pozitiv të theksuar pritet të ketë përmirësimi i cilësisë së portfolios kreditore dhe rritja e konkurrencës në mes të bankave në vend.

Kërkesa për kredi

Në tremujorin e tretë të vitit 2019, bankat raportuan për kërkesë të rritur për kredi nga segmenti i ekonomive familjare. Për dallim nga ndryshimet në kërkesën për kredi gjatë tremujorit të dytë, ku kishte rritje të theksuar të kërkesës, ky tremujor u karakterizua me rritje dukshëm më të ulët. Segmenti me kërkesën më të lartë ishte ai për kreditë afatshkurtra konsumuese, ku indeksi për kërkesën për kredi konsumuese arriti në 0.14 ndërsa ai për kërkesën për kredi afatshkurta arriti një indeks pozitiv prej 0.18. Situata aktuale del të jetë e ndryshme nga ajo çfarë kanë pritur bankat për periudhën e njëjtë, të raportuar në anketën e kaluar (figura 6).

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Burimi: BQK.

Kjo rritje u mbështet deri në një masë nga perspektiva e kënaqshme e tregut të patundshmërive dhe nevoja për financimin e konsumit, ndërsa në një nivel më të ulët ndikim kishte edhe rritja e besueshmërisë së huamarrësve në aftësinë e tyre paguese.

Sa i përket cilësisë së aplikacioneve të pranuara, përmirësim kishin aplikacionet për kreditë për blerjen e shtëpive me një indeks pozitiv prej 0.21, përderisa cilësia e aplikacioneve për kreditë konsumuese mbeti kryesisht e pandryshuar.

Në tremujorin e fundit të këtij viti, bankat presin rritje shumë më të lartë të kërkesës për kredi, e veçanërisht për kreditë afatgjata për blerjen e shtëpive. Rritje pritet të ketë po ashtu edhe kërkesa për kredi konsumuese, duke u bazuar në një periudhë kur shpenzimet e konsumatorëve rriten me rastin e festave të fund vitit.


Financimi

Bankat raportuan për përmirësim të qasjes në financim të bankave në Kosovë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019. Duke marrë parasysh modelin tradicional të sektorit bankar në Kosovë, financimi vazhdoi të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare dhe të ndërmarrjeve. Për më tepër, rezultatet e anketës tregojnë që financimi i bankave sipas maturitetit dominohet nga financimi afatshkurtër (figura 7). Nga këto rezultate del që depozitat, si burim kryesor i financimit për sektorin bankar, vazhdojnë të dominohen nga ato me maturitet më të shkurtër.

Për tremujorin e ardhshëm, bankat presin rritje të qasjes në financim, megjithëse në intensitet më të ulët. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare do të përmirësohet më tutje, ndërsa financimi nga ana e depozitave të ndërmarrjeve pritet të ketë rënie në krahasim me tremujorin paraprak. Për dallim nga tremujori i tretë 2019, financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare pritet të rrisë mbështetjen për financimin e aktiviteteve të sektorit bankar në vend.

Sa i përket pritjeve për financim sipas periudhës së maturimit, bankat presin ecure të ndryshme në krahasim me TM3 2019. Në tremujorin vijues anketat sinjalizojnë pritjet për rritjen e financimit afatgjatë, përderisa financimi afatshkurtër pritet të jetë dukshëm më i ulët (figura 7).

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



Burimi: BQK.

Pritjet për Inflacionin

Hyrje

Me qëllim të avancimit të kapaciteve analitike, BQK ka hulumtuar mbi praktikat më të mira rajonale dhe më gjerë, për të zhvilluar një pyetësor që do të adresojë pritjet e sektorit privat mbi dinamikën e inflacionit. Bazuar në praktikën rajonale, BQK ka shqyrtuar mundësinë për të filluar këtë anketim me institucionet financiare në vend, duke u mbështetur në hipotezën se institucionet financiare bartin praktikën më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar zhvillimet në çmime. Si rezultat, nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKB është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet në çmime në vend, duke ndihmuar kështu dhe plotësuar analizat tona në aspektin e analizimit, modelimit dhe parashikimit.

Përveç deklaratimit të bankave lidhur me pritjet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin e katërt të vitit 2019, pyetësori adreson edhe për pritjet e bankave për vitin 2020. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifikë që potencialisht mund të ndikojnë pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit.

Duke marr parasysh që anketa mbi pritjet e bankave për nivelin e inflacionit është në fazën fillestare të implementimit, seria kohore në dispozicion është e kufizuar dhe nuk mundëson analiza krahasuese në këtë fazë.

Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivitetit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore.

Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e lartë për vendet të cilat e kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, ndër të tjera, shërbejnë edhe si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse besohet se banka qendrore do të reagojë për të arritur objektivin, atëherë edhe pritjet e agjentëve ekonomikë lidhur me shkallën e inflacionit do të ishin më pranë objektivit. Pritjet e inflacionit janë të rëndësishme edhe për bankat të cilat nuk posedojnë politikë monetare, duke qenë se shërbejnë si input i rëndësishëm në përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe në procesin e modelimit dhe parashikimit. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë kërkesën agregate, që më pas ndikon ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Ndër më të përdorurat është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. Banka Qendrore e Kosovës, për herë të parë ka filluar me vlerësimin e pritjeve për inflacionin duke filluar nga tremujori i tretë i vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale dhe në të ardhmen pritet të zgjerohet edhe me agjent të tjerë ekonomikë.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore të shoqëruara edhe me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore, fillimisht pritjet për tërë vitin aktual, shoqëruar edhe me tremujorët e mbetur të atij viti por edhe pritjet e inflacionit për vitin e ardhshëm. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemit, përpunimit dhe agregimit për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale. Analiza e pritjeve të inflacionit pritet të jetë pjesë e raporteve të rregullta të BQK-së.

Përmbledhja e rezultateve

Bazuar në anketën e realizuar në tetor të vitit 2019, të gjitha bankat presin që inflacioni do të jetë më i lartë në vitin 2019 krahasuar me vitin e kaluar, dhe pothuajse të gjitha bankat presin që inflacioni do të jetë më i ulët në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Kur bëhet fjalë për nivelin e inflacionit, mesatarisht bankat presin që inflacioni do të jetë 2.6% në vitin 2019 dhe 2.1% në vitin 2020 (tabela 1).

Tabela 1. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje


Bankat	2019	2020	TM4 2019
1	2.7%	1.8%	2.8%
2	2.2%	1.8%	2.1%
3	2.8%	1.5%	2.3%
4	2.0%	2.4%	2.0%
5	2.2%	1.7%	2.2%
6	2.9%	1.6%	2.9%
7	2.8%	3.2%	3.2%
8	2.2%	1.3%	2.2%
9	3.4%	3.5%	3.4%
Mesatarja	2.6%	2.1%	2.6%

Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.

Edhe të dhënat e publikuara nga Agjensia e Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2019, sugjerojnë se inflacioni ishte rreth 2.7 përqind, që është nivel i përafërt me pritjet e bankave. Në anketën e realizuar me bankat komerciale në tremujorin e kaluar, pritjet e bankave kanë qenë se niveli i inflacionit do të jetë rreth 2.5 përqind në tremujorin e tretë dhe 2.6 përqind në tremujorin e katërt 2019. Të dhënat aktuale për tremujorin e tretë sugjerojnë se niveli i inflacionit në këtë tremujor ishte 2.6 përqind ndërsa për tremujorin e katërt, në anketën e fundit të realizuar me bankat komerciale, pritjet e bankave mbeten të pandryshuara. Bankat kanë pritje të ngjashme rreth zhvillimit të shkallës së inflacionit në tremujorin e katërt. Dy banka presin që inflacioni të sillet ndërmjet 3.0 përqind dhe 4.0 përqind, ndërsa bankat tjera presin që inflacioni të jetë mes 2.0 përqind dhe 3.0 përqind. Siç ilustron figura 8, shpërndarjet e raportuara të probabilitetit tregojnë një pasiguri relativisht të ulët në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit, pasi shpërndarja e probabilitetit të bankave është e përqendruar në inflacionin e pritur. Mesatarisht, probabiliteti që niveli i inflacionit do të jetë në intervalin 2.0 deri në 2.4 është 34.4 përqind, ndërsa probabiliteti që niveli i inflacionit do të jetë në intervalin 2.5 deri në 2.9 është 21.3 përqind. Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë cituar disa faktorë të mundshëm për inflacionin më të lartë në vitin 2019:

- ✓ Taksa në importet nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina;
- ✓ Pritja që aktiviteti ekonomik në vitin 2019 do të jetë më i lartë se një vit më parë;
- ✓ Prodhim i ulët në Kosovë dhe varësia e lartë nga importet;
- ✓ Zhvillimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare;
- ✓ Marrëdhëniet tregtare midis SHBA-së dhe Kinës.

Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM4 2019 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.

Pritjet e bankave lidhur me dinamikën në shkallën e inflacionit kanë qenë të sakta për vitin 2019, pasi që të dhënat e publikuara në ndërkohë nga ASK-ja lidhur me inflacionin aktual kanë shfaqur vlera të ngjashme me pritjet e bankave. Edhe për vitin 2020, pritjet e bankave janë në përputhje me parashikimet e BQK-së, të cilat sugjerojnë nivel më të ulët të inflacionit krahasuar me vitin paraprak.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org